

UDHËZIM
Nr. 26, datë 2.8.2013

PËR PËRCAKTIMIN E DETYRAVE DHE FUNKSIONEVE TË KËSHILLIT TË MËSUESVE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU 1
FUNKSIONET E KËSHILLIT TË MËSUESVE

Këshilli i mësuesve ka për funksion:

- a) të shqyrtojë zbatimin e akteve të legjislacionit arsimor dhe të këshillojë përmirësime në drejtimin e institucionit;
- b) të analizojë periodikisht arritjet e nxënësve dhe të këshillojë përmirësimet në veprimtarinë e institucionit arsimor që çojnë në arritje më të mira të nxënësve;
- c) të marrë pjesë në procedurat e emërimit dhe të largimit të mësuesit, drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit arsimor.

KREU 2
DETYRA TË KËSHILLIT TË MËSUESVE

Këshilli i mësuesve ka për detyrë:

- a) të shqyrtojë rregullisht përvojat e suksesshme të mësuesve të institucionit;
- b) të shqyrtojë praktikat e suksesshme të kolegëve të institucioneve arsimore vendase dhe të sugjerojë mënyrat e zbatimit të tyre;
- c) të kryejë studime për praktikat e suksesshme të institucioneve analoge të huaja dhe të sugjerojë mënyrat e zbatimit të tyre.

Këto funksione realizohen nga grupe mësuesish ose mësues të veçantë të caktuar nga drejtori i institucionit arsimor ose të propozuar paraprakisht nga mësuesit.

KREU 3
ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT TË MËSUESVE

1. Këshilli i mësuesve mbledhet, si rregull, jo më pak se një herë në muaj.
Këshilli mbledhet edhe në rastet kur e gjykon të arsyeshme drejtori i institucionit arsimor ose kur e kërkon jo më pak se 1/3 e anëtarëve të tij.
2. Mbledhjen e parë këshilli i mësuesve e zhvillon të paktën dhjetë ditë para fillimit të vitit shkollor.

Në këtë mbledhje këshilli i jep mendime drejtorit për:

- formimin e klasave;
- orarin mësimor;
- tematikat e përafërta të mbledhjeve të zakonshme të këshillit;
- veprimtaritë e zhvillimit të brendshëm profesional;
- çështje të tjera, sipas kërkesës së drejtorit ose me nismën e këshillit.

3. Në përfundim të vitit mësimor, këshilli i mësuesve analizon veprimtarinë vjetore të institucionit dhe rekomandon synimin dhe objektivat për vitin e ardhshëm.

4. Drejtori i institucionit arsimor vendos që në mbledhje të caktuara të këshillit të mësuesve të bëjnë pjesë, mësuesit ndihmës dhe instruktorët, si dhe nga personeli i konviktit dhe personeli ndihmës (nëse ka të tillë).

5. Në mbledhjet e këshillit të mësuesve, drejtori ka të drejtë të ftojë përfaqësues të njësisë bazë përkatëse të qeverisjes vendore, të njësisë arsimore vendore, punonjës in psiko-social, kryetarin e bordit, kryetarin e këshillit të prindërve, kryetarin e qeverisë së nxënësve, kryetarin e komisionit të etikës dhe sjelljes ose të deleguar të tyre, personelin mjekësor të shkollës (kur ka të tillë), si dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti.

6. Drejtori cakton një mësues si sekretar të këshillit.

Sekretari mban shënimet e mbledhjeve në protokollin e Këshillit të Mësuesve dhe vendos në arkivin e institucionit materialet e paraqitura në këshill nga drejtuesit e institucionit dhe mësuesit.

Dokumentacioni i këshillit të mësuesve është objekt i kontrollit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj